

20091332569

L I G J
PËR NGARKIMIN ME HUA TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR
ZHVILLIM PRANË KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË
PËR HUA PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT PËR STREHIMIN E
GRUPEVE TË CENUESHME SOCIALE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës, me hua në shumë prej 25 350 000 euro, për financimin e pjesëshëm të Projektit për strehimin e grupeve të cenueshme delikate.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen kornizë për hua për financimin e pjesëshëm të projektit për strehimin e grupeve të cenueshme sociale, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës.

Kushtet e shfrytëzimit të mjeteve për çdo transhe veç e veç, do të përcaktohen me Marrëveshjet plotësuese për hua, të cilat janë pjesë përbërëse të Marrëveshjes kornizë për hua, për financimin e pjesëshëm të projektit për strehimin e grupeve të cenueshme sociale.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen kornizë për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 20 vite, me grejs periudhë prej pesë vitesh. Huaja do të tërhiqet në së paku dy transhe.

Transha e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 33% të shumës së përgjithshme të huas.

Tërheqja e çdo transhe vijuese do të realizohet, pasi që Republika e Maqedonisë do ta informojë me shkrim Bankën për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës, se 90% e vlerës së trashës është alokuar.

Neni 4

Shkalla e kamatës do të përcaktohet për çdo transhe të huas veç e veç, në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, varësisht se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variable).

Neni 5

Projektin për strehimin e grupeve të cenueshme sociale nga Marrëveshja kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji, do ta realizojë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.